



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 169**

**24 tetor**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i ERE nr. 97, datë 13.9.2013	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Bardhgjane” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Bisak” .....	7471
Vendim i ERE nr. 102, datë 1.10.2013	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Gjoka Konstruksion - Energji” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	7472
Vendim i ERE nr. 103, datë 1.10.2013	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Gjoka Konstruksion - Energji” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues nga hecet “Lenie”, “Shales” dhe “Strelcë”...	7473
Vendim i ERE nr. 104, datë 1.10.2013	Për rinovimin e licencës së shoqërisë “Gen - I Tirana” sh.p.k. me nr. 73, seria FK08, në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 129, datë 2.12.2008.....	7474
Vendim i ERE nr. 105, datë 1.10.2013	Për rinovimin e licencës së shoqërisë “Gen - I Tirana” sh.p.k. nr. 74, me seri T08 për tregtimin e energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 130, datë 2.12.2008.....	7475
Vendim i ERE nr. 106, datë 1.10.2013	Për licencimin e shoqërisë “Hidrocentrali Cangonj” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Cangonj”	7476
Vendim i ERE nr. 107, datë 1.10.2013	Për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Cangonj”, të shoqërisë “Hidrocentrali Cangonj” sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie.....	7477
Vendim i ERE nr. 108, datë 1.10.2013	Për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Juana” sh.p.k. nga hec “Orenje” me nr. 14, seria PV04P, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 5, datë 12.3.2004.....	7477

Vendim i ERE nr. 109, datë 1.10.2013	Për licencimin e shoqërisë “Shutina Energji” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	7478
Vendim i ERE nr. 110, datë 1.10.2013	Për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Stravaj” si burim i rinovueshëm energjie .....	7479
Vendim i ERE nr. 111, datë 1.10.2013	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Wonder” sh.a. për transferimin e licencës së prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike nga shoqëria “Wonder Power” sh.a. te shoqëria “BHP Energy” sh.p.k. ....	7480
Vendim i ERE nr. 112, datë 1.10.2013	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Gjoka Konstruksion - Energji” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Lenie”, “Shales” dhe “Strelcë”....	7481
Vendim i ERE nr. 113, datë 7.10.2013	Mbi një ndryshim në vendimin nr. 134, datë 17.9.2012 të marrëveshjes së furnizimit me energji elektrike midis shoqërisë KESH sh.a./FPPSH dhe shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a./FPP për periudhën 1.1.2012 - 31.12.2014, të ndryshuar .....	7482
Vendim i ERE nr. 114, datë 7.10.2013	Për modifikimin e licencës së shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k. me nr. 102, seria PV10P “Për prodhimin e energjisë elektrike” nga hec “Selcë”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 39, datë 5.5.2010.....	7483
Vendim i ERE nr. 115, datë 7.10.2013	Për modifikimin e licencës së shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k. me nr. 16, seria PV04P “Për prodhimin e energjisë elektrike” nga hec “Tamarë”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 39, datë 22.7.2004.....	7484
Vendim i ERE nr. 116, datë 7.10.2013	Për ndryshimin e rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin nr. 1, datë 10.1.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.....	7485
Vendim i ERE nr. 117, datë 8.10.2013	Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të administratorit të përkohshëm të shoqërisë “CEZ Shpërndarje”...	7485
Vendim i ERE nr. 118, datë 18.10.2013	Për emërimin e administratorit të përkohshëm të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.....	7486

**VENDIM**  
**Nr. 97, datë 13.9.2013**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BARDHGJANE”  
SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGIJISË ELEKTRIKE NGA HEC  
“BISAK”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a” dhe nenit 10 pikat 1, 3 dhe 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Bardhgjane” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Bardhgjane” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Neni 9, pika 4.1.5, leje nga institucione të tjera, është plotësuar plotësisht.
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Bardhgjane” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Bisak”.
  2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI NË DETYRË**  
**Shkëlqim Bozgo**



**VENDIM**  
**Nr. 102, datë 1.10.2013**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GJOKA  
KONSTRUKSION - ENERGJI” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 8 dhe 10 pika 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve” nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gjoka Konstruksion - Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Gjoka Konstruksion - Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Gjoka Konstruksion - Energji” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, sipas procedurave standarde të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI NË DETYRË**  
**Shkëlqim Bozgo**

**VENDIM**  
**Nr. 103, datë 1.10.2013**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË  
“GJOKA KONSTRUKSION - ENERGJI” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT  
PRODHUES NGA HECET “LENIE”, “SHALES” DHE “STRELCË”**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 8 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, nenit 18 pika 1 germa “d” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 1.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gjoka Konstruksion - Energji” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për hecet “Lenie”, “Shales” dhe “Strelcë”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Gjoka Konstruksion - Energji” sh.p.k., është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit ...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Gjoka Konstruksion - Energji” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues nga hecet “Lenie”, “Shales” dhe “Strelcë”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI NË DETYRË**  
**Shkëlqim Bozgo**



**VENDIM**  
**Nr. 104, datë 1.10.2013**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “GEN - I TIRANA” SHPK ME NR. 73,  
SERIA FK08, NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGIJË  
ELEKTRIKE, LËSHUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE  
NR. 129, DATË 2.12.2008**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13 pika 1, nenit 45 pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f”, 5 pika 1 germa “f”, 12, 13, 14 pika 1 dhe nenit 16 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “GEN - I Tirana” sh.p.k., për rinovimin e licencës së furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Gen - I Tirana” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/9, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Rinovimin e licencës së shoqërisë “Gen - I Tirana” sh.p.k. me nr. 73, seria FK08, për kryerjen e aktivitetit të furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 129, datë 2.12.2008, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI NË DETYRË**  
**Shkëlqim Bozgo**

**VENDIM**  
**Nr. 105, datë 1.10.2013**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “GEN - I TIRANA” SHPK NR. 74, ME  
SERI T08 PËR TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, LËSHUAR ME VENDIMIN E  
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 130, DATË 2.12.2008**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13 pika 1, nenit 45 pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 5 pika 1 germa “g”, 12, 13, 14 pika 1 dhe nenit 16 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “GEN - I Tirana” sh.p.k., për rinovimin e licencës së furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Gen - I Tirana” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/10, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Rinovimin e licencës të shoqërisë “Gen - I Tirana” sh.p.k., me nr. 74, seria T08, për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 130, datë 2.12.2008, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI NË DETYRË**  
**Shkëlqim Bozgo**



**VENDIM**  
**Nr. 106, datë 1.10.2013**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HIDROCENTRALI CANGONJ” SHPK NË  
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “CANGONJ”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a” dhe nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hidrocentrali Cangonj” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hidrocentrali Cangonj” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “Hidrocentrali Cangonj” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Cangonj” me fuqi 0.3 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI NË DETYRË**  
**Shkëlqim Bozgo**



**VENDIM**  
**Nr. 107, datë 1.10.2013**

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR HEC “CANGONJ”, TË  
SHOQËRISË “HIDROCENTRALI CANGONJ” SHPK, SI BURIM I RINOVUESHËM  
ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 9 pikat 1 dhe 2 germa “a” të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hidrocentrali Cangonj” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Cangonj”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hidrocentrali Cangonj” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”

Është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Hidrocentrali Cangonj” sh.p.k., për kualifikim të impiantit prodhues për hec “Cangonj”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI NË DETYRË**  
**Shkëlqim Bozgo**

**VENDIM**  
**Nr. 108, datë 1.10.2013**

**PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË  
SHOQËRISË “JUANA” SHPK NGA HEC “ORENJE” ME NR. 14, SERIA PV04P,  
LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 5,  
DATË 12.3.2004**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe nenet 10 dhe 15 pikat 1 dhe 2 germa “b”, pika 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e



Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Juana” sh.p.k., për ndryshimin e licencës nr. 14, seria PV04P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 5, datë 12.3.2004 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Juana” sh.p.k. plotëson kërkesat e rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”:

Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (është plotësuar tërësisht).

- Neni 15, pika 4, germa “b”:

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën e shoqërisë “Juana” sh.p.k. me nr. 14, seria PV04P, për prodhimin e energjisë elektrike nga hec “Orenje” me fuqi 75 KW, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 5, datë 12.3.2004.

2. Fuqia e instaluar e hec “Orenje”, nga 75 KW të bëhet 875 KW.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË  
Shkëlqim Bozgo

#### VENDIM

Nr. 109, datë 1.10.2013

#### PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SHUTINA ENERGJI” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, neneve 8, 9, 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2013, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Shutina Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Shutina Energji” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Shutina Energji” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË  
**Shkëlqim Bozgo**

#### VENDIM

**Nr. 110, datë 1.10.2013**

### **PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR HEC “STRAVAJ” SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 7 dhe 8 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 1.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Stravaj Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Stravaj” si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Stravaj Energy” sh.p.k., është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit ...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s



VENDOSI:

1. Të miratojë kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Stravaj”, si burim i rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË  
Shkëlqim Bozgo

VENDIM

Nr. 111, datë 1.10.2013

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË  
“WONDER” SHA PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT DHE TREGTIMIT  
TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA SHOQËRIA “WONDER POWER” SHA TE  
SHOQËRIA “BHP ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të nenit 9 dhe 20 pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 17 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, pikës 1.3 të licencës së aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e datës 1.10.2013, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Wonder Power” sh.a., shoqërisë “BHP Energy” sh.p.k.
2. Të fillojë procedurat për transferimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Wonder Power” sh.a., shoqërisë “BHP Energy” sh.p.k.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e shoqërive “Wonder” sh.a., “Wonder Power” sh.p.k. dhe “BHP Energy” sh.p.k. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË  
Shkëlqim Bozgo

**VENDIM**  
**Nr. 112, datë 1.10.2013**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GJOKA  
KONSTRUKSION-ENERGJI” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE NGA HECET “LENIE”, “SHALES” DHE “STRELÇË”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a” dhe nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gjoka Konstruksion - Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Gjoka Konstruksion - Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Gjoka Konstruksion - Energji” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Lenie”, “Shales” dhe “Strelçë”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI NË DETYRË**  
**Shkëlqim Bozgo**



**VENDIM**  
**Nr. 113, datë 7.10.2013**

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 134, DATË 17.9.2012 TË MARRËVESHJES SË  
FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE MIDIS SHOQËRISË KESH SHA/FPSH DHE  
SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA/FPP PËR PERIUdhËN 1.1.2012 - 31.12.2014,  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 4.12 dhe 4.13 germa “A”, pika 2 të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimit të Këshillit Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, pikës V.1 të “Rregullave të tregut të energjisë elektrike”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 7.10.2013, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s,

**VENDOSI:**

1. Pika 8.3/ii e vendimit nr. 134, datë 17.9.2012, ndryshuar me vendimin nr. 160, datë 26.11.2012 dhe me vendimin nr. 40, datë 16.4.2013, të marrëveshjes së furnizimit me energji elektrike, midis shoqërisë KESH sh.a./FPSH dhe shoqërisë “CEZ Shpërndarje”/FPP, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Në rastin e importit të një sasi më të vogël se humbjet reale në rrjetin e shpërndarjes, “CEZ Shpërndarje” do të kompensojë këtë sasi të energjisë elektrike të siguruar nga KESH sh.a., deri në fund të muajit  $m+2$ . Në rast se kompensimi nuk kryhet brenda periudhës  $m+2$ , “CEZ Shpërndarje” sh.a. është i detyruar të kompensojë KESH sh.a. në muajin  $m+3$ , me vlerën monetare që u afrohet kostove reale të shkaktuara shoqërisë KESH sh.a. për sigurimin e kësaj sasi të energjisë elektrike, duke respektuar renditjen e mënyrave të listuara më poshtë:

i) Kompensimi do të realizohet me çmimin mesatar të ponderuar të importit të energjisë elektrike të shoqërisë KESH sh.a. për muajin përkatës;

ii) Në mungesë të importit të energjisë elektrike nga ana e KESH sh.a., kompensimi do të bëhet me vlerën monetare që i korrespondon çmimit mesatar të ponderuar të eksportit në bandë të muajit “m” të shoqërisë KESH sh.a. për muajin përkatës;

iii) Së fundmi, në mungesë të referencave të mësipërme, kompensimi do të realizohet në vlerën monetare që i korrespondon çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike nga “CEZ Shpërndarje” për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes për muajin përkatës.”

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI NË DETYRË**  
**Shkëlqim Bozgo**

**VENDIM**  
**Nr. 114, datë 7.10.2013**

**PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “SELCA ENERGJI” SHPK ME  
NR. 102, SERIA PV10P “PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE” NGA HEC  
“SELCË”, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S  
NR. 39, DATË 5.5.2010**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe neneve 13, 14 pika 2, 15 pikat 1, 2 /b, 3, 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k., për ndryshimin e licencës nr. 102, seria PV10P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 39, datë 5.5.2010 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k., plotëson kërkesat ligjore siç kërkohet nga rregullorja “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës.

- Neni 15, pika 4, germa “b”: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të modifikojë licencën me nr. 102, seria PV10P, për prodhimin e energjisë elektrike nga hec “Selcë” me fuqi 400 KW, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 39, datë 5.5.2010.

2. Fuqia e instaluar e hec “Selcë”, nga 400 KW të bëhet 1600 KW.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI NË DETYRË**  
**Shkëlqim Bozgo**



**VENDIM**  
**Nr. 115, datë 7.10.2013**

**PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “WTS ENERGJI” SHPK ME NR. 16,  
SERIA PV04P “PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE” NGA HEC “TAMARË”,  
TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S  
NR. 39, DATË 22.7.2004**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe neneve 13, 14 pika 2, 15 pikat 1, 2 /b, 3, 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k., për ndryshimin e licencës nr. 16, seria PV04P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 39, datë 22.7.2004 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k., plotëson kërkesat ligjore, siç kërkohet nga rregullorja “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës.

- Neni 15, pika 4, germa “b”: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të modifikojë licencën me nr. 16, seria PV04P, për prodhimin e energjisë elektrike nga hec “Tamarë” me fuqi 150 KW, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 39, datë 22.7.2004.

2. Fuqia e instaluar e hec “Tamarë”, nga 150 KW të bëhet 750 KW.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI NË DETYRË**  
**Shkëlqim Bozgo**



**VENDIM**  
**Nr. 116, datë 7.10.2013**

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES “Mbi PROCEDURAT E EMËRIMIT TË ADMINISTRATORIT DHE KOMPETENCAT E TIJ, NË ZBATIM TË NENIT 18, PIKA 4/C TË LIGJIT NR. 9072, DATË 22.5.2003 “PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 1, DATË 10.1.2013 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 18 pika 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 19 të rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.10.2013, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike,

**VENDOSI:**

1. Ndryshimin e rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, në zbatim të nenit 18 pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI NË DETYRË**  
**Shkëlqim Bozgo**

**TEKSTI I NDRYSHIMIT TË RREGULLORES**

Pika “a” e nenit 6 shfuqizohet.

Pika “c” e nenit 6 ndryshohet si vijon: “Të ketë një eksperiencë pune si drejtues ekzekutiv për një periudhë jo më pak se 5-vjeçare në sektorin publik apo privat”.

Pas pikës 7 të nenit 12, shtohet pika 8, me përmbajtje si vijon: “Brenda një periudhe 30-ditore nga përfundimi i këtij procesi, administratori i përkohshëm njofton ERE-n”.

Pika 3 e nenit 14 ndryshohet si vijon: “Harton një protokoll të pagesave ndaj palëve të treta sipas rregullave të modelit të tregut, i cili duhet të miratohet paraprakisht në ERE”.

Pika 1, “a”, “iii” e nenit 17 shfuqizohet.

Fjalialia e fundit e pikës 3 të nenit 17 shfuqizohet.

**VENDIM**  
**Nr. 117, datë 8.10.2013**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES DHE EMËRIMIT TË ADMINISTRATORIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE”**

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 18 pika 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013 “Për heqjen e licencave të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 8, datë 25.1.2008, të ndryshuar, dhe për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimet e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 25.1.2008, të ndryshuar”, vendimit nr. 5, datë 21.1.2013 të Bordit të



Komisionerëve të ERE-s “Për vendosjen e shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a., në administrim të përkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.”, në zbatim të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013 “Për heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.”, neni 4 i rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 10.1.2013, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.10.2013, pasi shqyrtoi kërkesën e administratorit aktual të përkohshëm të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” për lirim nga detyra dhe relacionin e drejtorive teknike të ERE-s,

#### VENDOSI:

1. Të pranojë dorëheqjen e paraqitur nga ana e administratorit aktual të shoqërisë, z. Sahit Dollapi, i cili do të vijojë ushtrimin e detyrës deri në momentin e përzgjedhjes së administratorit të ri të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
2. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes së administratorit të përkohshëm të shoqërisë “CEZ Shpërndarje”.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të përgatisë të gjitha procedurat në lidhje me zbatimin e këtij vendimi të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s  
**Petrit Ahmeti**

#### VENDIM Nr. 118, datë 18.10.2013

#### **PËR EMËRIMIN E ADMINISTRATORIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA**

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 18 pika 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013 “Për heqjen e licencave të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 8, datë 25.1.2008, të ndryshuar, dhe për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimet e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 25.1.2008, të ndryshuar”, vendimit nr. 5, datë 21.1.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për vendosjen e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. në administrim të përkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., në zbatim të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013 “Për heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.”, neneve 7 dhe 9 të rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 10.1.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 117, datë 8.10.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të administratorit të përkohshëm të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimet e kandidatëve për administrator të përkohshëm të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.,

VENDOSI:

1. Emërimin e z. Arben Seferi si administrator i përkohshëm i shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., që të operojë dhe të mirëmbajë pajisjet, pasuritë dhe mjetet monetare, dhe llogaritë bankare të shoqërisë.

2. Të gjitha funksionet dhe kompetencat e administrimit të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., i kalojnë administratorit të emëruar nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

3. Administratori i emëruar sipas pikës 1 të këtij vendimi, në administrimin e përditshëm të shoqërisë do të zbatojë rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, në zbatim të nenit 18 pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

4. Administratori i emëruar sipas pikës 1 të këtij vendimi, nuk mund të transferojë asnjë aset ose pasuri materiale të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., nëpërmjet shitjes, pengut, qirasë, shkëmbimit apo formave të tjera.

5. Depozitimi dhe publikimi i këtij vendimi në të dhënat e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., me numër NIPT: K72410014H, do të realizohet sipas autorizimit bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë menjëherë administratorin e emëruar sipas pikës 1 të këtij vendimi, shoqërinë “CEZ Shpërndarje” sh.a., QKR-në dhe çdo subjekt tjetër të interesuar për zbatimin e këtij vendimi të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Petrit Ahmeti**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 20 lekë